



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministri of Education, Science and Technology

 **Instituti Pedagogjik i Kosovës**

Plani zhvillimor i Institutit Pedagogjik të Kosovës 2013 -2016

Prishtinë, dhjetor 2012

Përmbajtja

Shkurtesat	2
1. Hyrje	3
2. Analiza e gjendjes	4
2.1. Hyrje	4
2.2. Qeverisja e Institutit Pedagogjik	4
2.3. Sektori i hulumtimit	5
2.4. Sektori i planifikimit mësimor	6
2.5. Sektori i arsimit	7
2.6. Sektori i arsimit permanent	8
3. Vizioni, misioni dhe objektivat strategjike	10
3.1. Objektiva 1.: Zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese dhe hulumtuese për të përmbushur me sukses vizionin dhe misionin e Institutit Pedagogjik të Kosovës	11
3.2. Objektiva 2.: Ngritje e cilësisë së hulumtimeve dhe shërbimeve profesionale për institucionet arsimore në fushën e planifikimit shkollor, inovacioneve dhe studimeve krahasuese, dhe hulumtimeve sociale.	12
3.3. Objektiva 3.: Ngritje e cilësisë së hulumtimeve dhe shërbimeve profesionale për institucionet arsimore në fushën e planeve dhe programeve mësimore, standardeve arsimore, vlerësimit dhe zhvillimit profesional.	13
3.4. Objektiva 4.: Ngritje e cilësisë së hulumtimeve dhe shërbimeve profesionale për institucionet arsimore në fushën e arsimit të përgjithshëm, arsimit profesional dhe arsimit special.	14
3.5. Objektiva 5.: Ngritje e cilësisë së hulumtimeve dhe shërbimeve profesionale për institucionet arsimore në fushën e arsimit gjatë gjithë jetës, arsimit në distancë dhe arsimit joformal.	15
4. Plani i veprimit dhe buxheti	17
5. Zbatimi dhe plani i monitorimit	62

Shkurtesat

BB	Banka Botërore
BEP	Programi i Arsimit Themelor
BKK	Buxheti i konsoliduar i Kosovës
DKA	Drejtori Komunale e Arsimit
ETF	Fondacioni Evropian për Trajnime
GIZ	Bashkëpunimi Zhvillimor Gjerman
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KE	Këshilli i Evropës
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KD	Këshilli Drejtues
KKK	Korniza e Kurrikulës Kosovës
KSH	Këshilli Shkencor
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
PIA	Plani Individual i Arsimit
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
SHMF	Shkollë Mike për Fëmijë
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
SWAP	Qasja Tërësektoriale në Arsim
SWOT	Sukseset, Dobësitë, Mundësitë, Rreziqet
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

1. Hyrje

Instituti Pedagogjik i Kosovës, është institucion i ri profesional, i themeluar si institucion i pavarur publik në varësi të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që merret me hulumtime, trajnime, vlerësime, eksperimentime dhe inovacione në fushën e arsimit.

Ideja për hartimin e Planit Zhvillimor të Institutit Pedagogjik të Kosovës mbështetet në kërkesat e stafit hulumtues me qëllim që të përmirësohet cilësia e planifikimit dhe të përmbushën detyrat dhe përgjegjësitë e parapara për gjithë stafin e IPK. Udhëzimi Administrativ për funksionimin e IPK, raportet dhe planet e punës së IPK në këtë fazë, si dhe dokumentet strategjike për zhvillimin e arsimit ishin pikënisja e këtij planifikimi. Bartës të procesit të planifikimit ishin drejtori i IPK dhe udhëheqësit e sektorëve.

Procesi i planifikimit u zhvillua në katër faza:

- i. **Faza e parë** - u realizua gjatë gjysmës së parë të muajit Maj 2012. Kjo fazë ka përfshirë dy aktivitete kryesore:
 1. Mbledhjen e të dhënave të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit të planifikimit. Për këtë aktivitet nga zyrtarja për administratë dhe udhëheqësit e sektorëve kanë mbledhur të dhënat nga planet e veprimit raportet e punës së sektorëve për progresin dhe ngecjet në kryerjen e aktiviteteve, bashkëpunimit me institucione, etj.
 2. Aktivitetet përgatitore për organizimin e procesit të hartimit të Planit Zhvillimor. Drejtori i IPK përcaktojë një hulumtues nga IPK që të koordinojë dhe organizojë aktivitetet për hartimin e Planit Zhvillimor.
- ii. Faza e dytë - u realizua me 30 dhe 31 Maj 2012 . Kjo fazë përfshinë realizimin e një punëtorie 2 ditore me pjesëmarrje të gjithë stafit të IPK. Gjatë kësaj punëtorie u bë një prezantim për strukturën e Planit Zhvillimor dhe u bë analiza SWOT e gjendjes në IPK, mbi bazën e së cilës është bërë përshkrimi i gjendjes ekzistuese.
- iii. Faza e tretë - u realizua me 21 Dhjetor 2012. Kjo fazë përfshinë realizimin e një punëtorie 1 ditore me pjesëmarrje të gjithë stafit të IPK për diskutimin e draftit të dokumentit – vizionit, objektivave strategjike dhe aktiviteteve për arritjen e tyre. Në këtë punëtorie gjithashtu u hartua plani i veprimit dhe vlerësimi i përafërt i buxhetit të nevojshëm për zbatimin e Planit Zhvillimor.
- iv. Faza e katërt - u realizua në gjysmën e parë të muajit janar 2013. Kjo fazë përfshinë hartimin e versionit përfundimtar të Planit Zhvillimor të Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe miratimin nga Këshilli Drejtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës.

2. Analiza e gjendjes

2.1. Hyrje

Analiza e gjendjes së Institutit Pedagogjik të Kosovës e prezantuar në këtë pjesë mbështet në raportet e rregullta të punës së IPK, si dhe në analizën SWOT që është realizuar me 30 dhe 31 Maj 2012 me pjesëmarrje të gjithë stafit të IPK-së. Po ashtu për analizën e gjendjes janë marrë parasysh dokumente strategjike për zhvillimin e arsimit në Kosovë, në mënyrë të veçantë Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2011 – 2016.

Për çështje praktike, analiza SWOT është përqendruar në fushën e menaxhimit dhe në veprimtarinë e katër sektorëve të IPK-së

1. Qeverisja e Institutit Pedagogjik
2. Sektori i hulumtimit
3. Sektori i planifikimit mësimor
4. Sektori i arsimit
5. Sektori i arsimit permanent

2.2. Qeverisja e Institutit Pedagogjik

Instituti Pedagogjik i Kosovës, veprimtarinë e vet e mbështet në :

- Ligjin për veprimtarinë kërkimore – shkencore Nr.2004/42
- Udhëzimin Administrativ: Instituti Pedagogjik i Kosovës, nr. 8/2011, datë 14.10.2011

Bazuar në Udhëzimin Administrativ të IPK, organizimi dhe qeverisja e IPK bëhet nga drejtori i IPK dhe Këshilli Drejtues. Ndërsa, lidhur me çështjet profesionale merret Këshilli Shkencor. Në dy vitet e fundit ka pasur një progres modest të angazhimeve të stafit udhëheqës dhe drejtues në qeverisjen dhe udhëheqjen e Institutit pedagogjik. Me gjithë progresin e arritur, akoma nuk mund të flasim për një funksionalizim të plotë të tyre, sepse janë shënuar vonesa në marrjen e vendimeve të duhura si për miratimin e planeve vjetore të punës, miratimin e buxhetit vjetor, aprovimin e statutit të IPK, aprovimin e rregullores së brendshme, parapërgatitjen e programit dhe vlerësimin e aktiviteteve shkencore, etj.

Instituti pedagogjik i mungojnë disa akte normative që rregullojnë sistematizimin e vendeve të punës në IPK, përshkrimin e detyrave dhe pagës së shefave të sektorëve, pagesat e angazhimeve të antërave të KD dhe KSH. Gjithashtu Institutit Pedagogjik i mungojnë memorandumet e mirëkuptimit me MASHT, DKA dhe shkolla për kryerjen e hulumtimeve dhe aktiviteteve të tjera me interes të përbashkët.

Përkundrajt përpjekjeve të stafit menaxhues të IPK, akoma nuk është arritur të sigurohet hapësirë e qëndrueshme për selinë e IPK dhe në mungesë të hapësirës së qëndrueshme dhe të

mjaftueshme për kryerjen e veprimtarive, nuk janë përmbushur në masë të duhur objektivat e IPK të parapara me aktin e themelimit të tij.

Sfidat kryesore:

- Ushtrimi i autorizimeve ligjore nga Këshilli Drejtues dhe Këshilli Shkencor,
- Përmirësimi i planifikimit të punës në IPK;
- Ushtrimi i veprimtarisë së IPK në bazë të kërkesave/ofertave nga MASHT, DKA dhe institucionet shkollore;
- Sigurimi i hapësirës së qëndrueshme – selisë së IPK.

Aprovimi i Ligjit të ri për veprimtari shkencore, shihet si një mundësi e mirë që duhet shfrytëzuar për përmirësimin dhe avancimin e qeverisjes dhe udhëheqjes së IPK, sepse me këtë ligj pritët të sigurohet një bazë më e mirë për marrjen e vendimeve të pavaruara nga Instituti Pedagogjik, si për organizim të brendshëm, ashtu edhe për veprimtari hulumtuese – shkencore.

Hartimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016 (hartuar me përkrahjen e projektit SĚAP), hartimi i planeve zhvillimore të arsimit nga komunat e Kosovës dhe institucionet shkollore, shihen si mundësi e mirë që duhet shfrytëzuar për të mbështetur projektet e IPK në bazë të kërkesave dhe nevojave të adresuara nga MASHT, DKA dhe Institucioneve shkollore.

Disa nga rreziqet me të cilat mund të përballët Instituti Pedagogjik nga këndveshtrimi i qeverisjes dhe udhëheqjes së tij janë: mundësia e politizimit të emrimeve të këshillit drejtues dhe këshillit shkencor, ikja e antërave të këtyre dy këshillave për shkak të mungësë së buxhetit për pagesë të angazhimeve të tyre shtesë, etj.

2.1. Sektori i hulumtimit

Instituti Pedagogjik i Kosovës ka sektorin e hulumtimeve në kuadër të të cilit zhvillohen hulumtime dhe aktivitete të tjera në fushën e planifikimit shkollor, inovacioneve dhe studimeve krahasuese, dhe hulumtimeve sociale. Ky sektor është i përbërë prej gjashtë hulumtueseve. Deri me tani ky sektor ka kryer disa hulumtime, ku pjesa më e madhe e tyre janë publikuar në botimet vjetore të Instituti Pedagogjik dhe disa sish edhe në revistën Mësuesi i Kosovës. Disa hulumtues të këtij sektori kanë qenë të përfshirë në grupe punuese së bashku me përfaqësues të MASHT-it dhe ekspertë të tjerë zhvillimin e dokumenteve të ndryshme me interes për IPK dhe MASHT.

Me gjithë faktin se sektori i hulumtimeve, për dallim prej sektorëve të tjerë të IPK, ka numrin më të madh të hulumtuesve, deri në këtë fazë ky sektor nuk ka arritur që në masë të nevojshme ti realizojë detyrat keyesore të sektorit, si: bashkërendimin e veprimeve dhe aktiviteteve me shkolla për planifikimin shkollor, hulumtimet në fushën sociale, hartimin e materiale mbështetëse për implementimin e inovacioneve në arsim, etj. Kapacitet hulumtuese vazhdojnë të jenë relativisht të kufizuara, ndërsa nevojat e hulumtimeve në fushat që mbulon sektori janë shumë të mëdha

Sfidat kryesore:

- Kapacitetet për hulumtime në të gjitha fushat që mbulon sektori

- Bashkërendimi i veprimeve dhe aktiviteteve brenda sektorit dhe me gjerë
- Kapacitetet për ofrimin e materialeve mbështetëse për implementimin e inovacioneve në arsim.

Një mundësi që duhet shfrytëzuar nga sektori i hulumtimeve në IPK është fillimi i zbatimit të kurrikulës së re dhe kërksat për zbatimin e risive që dalin nga kjo kornizë. Duhet shfrytëzuar këtë mundësi duke bashkëpunuar me komunat dhe institucionet shkollore në mënyrë që hulumtuesit e sektorit të zhvillojnë hulumtime dhe shërbime të tjera profesionale në fushat që i mbulon sektori. Po ashtu, sektori i hulumtimeve duhet të vendos një bashkëpunim me të mirë me sektoret në MASHT që kanë planifikuar aktivitete të përafërta me sektorin, me donatorët e ndryshëm që mbështesin fushat e arsimit që janë fushë e veprimtarisë së sektorit të hulumtimeve.

Në vitin e fundit është vërejtur një trend i largimit të donatorëve që përkrahin IPK për shkak se MASHT po i konsideron hulumtuesit e IPK si shërbyes civil, kjo mund të rezultojë me mospërkrahje të projekteve të sektorit që kanë kosto buxhetore dhe rrejdhimisht mund të zvoglojë edhe aktivitetet e punës në terren. Një faktor tjetër i rrezikut për sektorin e hulumtimeve është konkurrenca e jashtme, sidomos në fushën e hulumtimeve që mbulojnë sferën sociale.

2.2. Sektori i planifikimit mësimor

Instituti Pedagogjik i Koosvës ka sektorin e planifikimit mësimor në kuadër të të cilit zhvillohen hulumtime dhe aktivitete të tjera në fushën e planeve dhe programeve mësimore, standardeve dhe vlerësimit, dhe zhvillimit profesional - trajnimeve. Aktualisht ky sektor është i përbërë prej katër hulumtueseve. Ashtu sikur sektorët tjerë të IPK, deri me tani ky sektor ka kryer disa hulumtime dhe analiza, ku pjesa më e madhe e tyre janë publikuar në botimet që nxjerrë Instituti Pedagogjik disa sish edhe në revistën Mësuesi i Kosovës. Gjithashtu hulumtuesit e këtij sektori në vitet e fundit kanë qenë të përfshirë në grupe punuese së bashku me përfaqësues të MASHT-it dhe ekspertë të tjerë në zhvillimin e dokumenteve të ndryshme, si: në zhvillimin e standardeve për tekstet shkollore, në zhvillimin e kornizës së vlerësimit për klasëne e pestë, në hartimin e standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, në hartimin e standardeve për shkollat mike për fëmijë, në hartimin e kurrikulave bërthamë, si dhe në hartimin e moduleve të trajnimit për udhëheqje arsimore.

Me gjithë faktin se sektori i planifikimit mësimor ka qenë mjaft i angazhuar në kryerjen e detyrave kryesore të sektorit, deri në këtë fazë nuk ka arritur që në masë të nevojshme ti realizojë disa nga detyrat e sektorit, si: bashkërendimin e veprimeve dhe aktiviteteve me shkolla për zhvillimin e materialeve mbështetëse për zbatim të planeve dhe programeve mësimore, zbatim të instrumenteve të ndryshme të vlerësimit të arritjeve të nxënësve, si dhe të ofrojë trajnime për mësime të mbështetura në nevojat dhe kërkesat e tyre.

Ashtu sikur në sektorët tjerë, edhe në këtë sektor kapacitetet hulumtuese vazhdojnë të jenë relativisht të kufizuara, ndërsa nevojat e hulumtimeve në fushat që mbulon sektori janë shumë të mëdha

Sfidat kryesore:

- Kapacitetet për hulumtime në të gjitha fushat që mbulon sektori;
- Bashkërendimi i veprimeve dhe aktiviteteve me departamentin e zhvillimit të arsimit parauniversitar në MASHT;
- Ofrimi i materialeve mbështetëse për zbatim të planeve dhe programeve mësimore, standardeve të vlerësimit, praktikave të mira nga trajnimet, etj.;
- Ofrimi i trajnimeve të mbështetura ne nevojat dhe kërkesat e mësimdhënësve.

Një mundësi që duhet shfrytëzuar nga sektori i planifikimit mësimor në IPK janë dokumentet strategjike, si Plani Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016, Korniza për zhvillim profesional me bazë në shkollë, etj. Duhet shfrytëzuar këtë mundësi duke bashkëpunuar me departamentin e zhvillimit të arsimit parauniversitar për arritjen e disa caqeve që janë të planifikuara nga ky departament dhe që janë fusha të veprimtarisë edhe të sektorit të planifikimit mësimor në IPK. Po ashtu, sektori i planifikimit mësimor duhet të vendos një bashkëpunim me të mirë me DKA për të realizuar projekte të përbashkëta në baza të decentralizimit të arsimit në komuna në fushat që i mbulon sektori. Mundësi tjetër që duhet shfrytëzuar është bashkëpunimi më i mirë me donatorët e ndryshëm që mbështesin fushat e arsimit që janë pjesë e veprimtarisë së sektorit të planifikimit mësimor.

Ashtu sikur për sektorët tjerë, edhe për këtë sektor është rrezik largimi i donatorëve që përkrahin IPK për shkak se MASHT po i konsideron hulumtuesit e IPK si shërbyes civil, mund të rezultojë me mospërkrahje të projekteve të sektorit që kanë kosoto buxhetore dhe rrejdhimisht mund të zvoglojë edhe aktivitetet e punës në terren. Një faktor tjetër i rreziku për sektorin e planifikimit mësimor është hapja e agjencionit të kurrikulave dhe vlerësimit, që shpesh hapja e këtyre agjensioneve reflektohet edhe me marrjen e përkrahjes nga institucioni qendror dhe donatorët.

2.3. Sektori i arsimit

Brenda Instituti Pedagogjik të Kosovës vepron sektori i arsimit i cili zhvillohen hulumtime dhe aktivitete të tjera në fushën e arsimit të përgjithshëm, arsimit profesional dhe arsimit special. Ky sektor është i përbërë prej katër hulumtueseve. Deri me tani ky sektor ka kryer disa hulumtime, ku pjesa më e madhe e tyre janë publikuar në botimet e Institutit Pedagogjik. Edhe hulumtuesit e këtij sektori në vitet e fundit kanë qenë të përfshirë në grupe punuese së bashku me përfaqësues të MASHT-it dhe ekspertë të tjerë në zhvillimin e dokumenteve të ndryshme, si: në zhvillimin e planit strategjik për arsimin gjithëpërfshirës, në zhvillimin e planeve dhe programeve mësimore në arsimin profesional, në hartimin e kurrikulave bërthamë, etj.

Përkundrejt faktit se sektori i arsimit ka qenë mjaft i angazhuar në kryerjen e detyrave kryesore të sektorit, deri në këtë fazë nuk ka arritur që në masë të nevojshme ti realizojë disa nga detyrat e sektorit, si: bashkërendimin e veprimeve dhe aktiviteteve me shkolla për realizimin e studimeve të mjaftueshme në fushat e sektorit dhe për zhvillimin e materialeve

mbështetëse për zbatim të planeve dhe programeve mësimore në arsimin profesional, arsimin e përgjithshëm dhe atë special.

Edhe në këtë sektor kapacitetet hulumtuese vazhdojnë të jenë relativisht të kufizuara, ndërsa nevojat e hulumtimeve, sidomos në arsimin dhe aftësimin profesional dhe atë special janë shumë të mëdha.

Sfidat kryesore:

- Kapacitetet për hulumtime në të gjitha fushat që mbulon sektori;
- Bashkërendimi i veprimeve dhe aktiviteteve me sektorin e arsimit dhe aftësimin profesional në MASHT;
- Bashkërendimi i veprimeve dhe aktiviteteve me sektorin e arsimit special në MASHT;
- Ofrimi i materialeve mbështetëse për të zbatimin e politikave arsimore në arsimin dhe aftësimin profesional, arsimin e përgjithshëm dhe atë special;
- Ofrimi i trajnimeve të mbështetura ne nevojat dhe kërkesat në arsimin dhe aftësimin profesional, arsimin e përgjithshëm dhe atë special.

Një mundësi që duhet shfrytëzuar nga sektori i arsimit në IPK janë planet strategjike të MASHT-it si: Strategjia për arsimin gjithëpërfshirës, Plani Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016, si dhe dokumentet strategjike për arsimin dhe aftësimin profesional. Duhet shfrytëzuar këtë mundësi duke bashkëpunuar me sektorin e arsimit dhe aftësimin profesional, sektorin e arsimit special dhe atë të përgjithshëm për arritjen e disa caqeve që janë të planifikuara nga këta sektor dhe që janë fusha të veprimtarisë edhe të sektorit të arsimit në IPK. Sektori i arsimit duhet të vendos një bashkëpunim me të mirë me qendrat rajonale të punësimin, agjencionet që mbështesin zhvillimin e arsimit dhe aftësimin profesional, qendrat burimore, si dhe DKA-të për të realizuar projekte të përbashkëta. Mundësi tjetër që duhet shfrytëzuar është bashkëpunimi më i mirë me donatorët e ndryshëm që mbështesin fushat e arsimit që janë pjesë e veprimtarisë së sektorit të arsimit.

Edhe për sektorin e arsimit është rrezik largimi i donatorëve që përkrahin IPK për shkak se MASHT po i konsideron hulumtuesit e IPK si shërbyes civil, kjo mund të rezultojë me mospërkrahje të projekteve të sektorit që kanë kosoto buxhetore dhe rrejdhimisht mund të zvoglojë edhe aktivitetet e punës në terren. Një faktor tjetër i rreziku për sektorin e arsimit është hapja e agjencionit të arsimit dhe aftësimin profesional, që mund të reflektohet me përkrahje më të madhe nga MASHT dhe donatorët.

2.4. Sektori i arsimit permanent

Instituti Pedagogjik i Kosovës ka edhe sektorin e arsimit permanent në kuadër të të cilit zhvillohen hulumtime dhe aktivitete të tjera në fushën e arsimit permanent, arsimin në distancë dhe arsimin joformal. Aktualisht ky sektor është i përbërë prej katër hulumtueseve. Ashtu sikur sektorët tjerë të IPK, deri me tani ky sektor ka kryer disa hulumtime dhe analiza, ku pjesa më e madhe e tyre janë publikuar në botimet që nxjerrë Instituti Pedagogjik, disa sish edhe në revistën Mësuesi i Kosovës.. Hulumtuesit e këtij sektori në vitet e fundit kanë qenë të

përfshirë në grupe punuese për zhvillimin e dokumenteve të ndryshme me interes për IPK dhe MASHT.

Edhe pse hulumtuesit e sektorit të arsimit permanent kanë qenë mjaft të angazhuar në kryerjen e detyrave kryesore të sektorit, deri në këtë fazë nuk kanë arritur që në masë të nevojshme ti realizojë disa nga detyrat e sektorit, si: bashkërendimin e veprimeve dhe aktiviteteve me institucione arsimore për hulumtime në fushat e sektorit dhe për zhvillimin e materialeve mbështetëse për zhvillimin e arsimit në fushat që mbulon sektori.

Ashtu sikur në sektorët tjerë, edhe në këtë sektor kapacitetet hulumtuese vazhdojnë të jenë relativisht të kufizuara, ndërsa nevojat e hulumtimeve në fushat që mbulon sektori vazhdojnë të jenë shumë të mëdha.

Sfidat kryesore:

- Kapacitetet për hulumtime në të gjitha fushat që mbulon sektori;
- Bashkërendimi i veprimeve dhe aktiviteteve brenda sektorit dhe me zyrën për arsim joformal në MASHT;
- Ofrimi i materialeve mbështetëse për zbatim e strategjisë për arsim dhe aftësim të të rriturve;
- Ofrimi i trajnimeve të mbështetura ne nevojat dhe kërkesat e institucioneve arsimore për arsim gjatë gjithë jetës, arsim në distancë, etj.

Një mundësi që duhet shfrytëzuar nga sektori i arsimit permanent në IPK janë ligji për arsimin dhe aftësimin e të rriturve dhe planet strategjike të MASHT-it si: Strategjia për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Kosovë 2007-2017, Plani Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016etj. Duhet shfrytëzuar këtë mundësi për të orientuar bashkëpunimin me institucione arsimore dhe praktikantët në arritjen e caqeve të synuara nga këto strategji dhe që janë fusha të veprimtarisë edhe të sektorit të arsimit permanent në IPK. Digjitalizimi i shkollave shihet si mundësi e mirë për avancimin e bashkëpunimit me shkolla, sepse përmes këtij procesi mund të promovohen me lehtë dhe më shpejtë vlerat e arsimit gjatë gjithë jetës, arsimit në distancë etj. Mundësi tjetër që duhet shfrytëzuar është edhe procesi i licencimit të mësimdhënësve, ky proces pritet të nxisë më shumë mësimdhënësit në shfrytëzimin e përmbajtjeve elektronike që lidhen me zhvillimin profesional dhe me procesin e mësimdhënies dhe nxënies.

Ashtu sikur për sektorët tjerë, edhe për këtë sektor është rrezik largimi i donatorëve që përkrahin IPK për shkak se MASHT po i konsideron hulumtuesit e IPK si shërbyes civil, mund të rezultojë me mospërkrahje të projekteve të sektorit që kanë kosto buxhetore dhe rrejdhimisht mund të zvoglojë edhe aktivitetet e punës në terren. Një faktor tjetër i rrezikut për sektorin e arsimit permanent është ndërrimi i prioriteteve nga bërsitë e politikave arsimore, që shpesh reflektohet edhe me ndërprerjen e aktiviteteve ose mospërkrahjen në përfundimin e aktiviteteve të nisura.

3. Vizioni, misioni dhe objektivat strategjike të IPK-së

Vizioni, misioni dhe objektivat strategjike të IPK-së janë përcaktuar në bazë të analizës së gjendjes, në bazë të veprimtarisë së IPK, akteve normative të themelimit të Institutit dhe në bazë të dokumenteve zhvillimore të arsimit në Kosovë. Vizioni paraqet ndryshimin që duam të shohim në procesin e zhvillimit të IPK, ndërsa misioni paraqet obligimin që merr IPK në përkrahje të zhvillimit të sistemit të arsimit në Kosovë. Objektivat strategjike paraqesin rrugën për jetësimin e vizionit, ato pritet të arrihen përmes aktiviteteve dhe masave adekuate që duhet ndërmarrë.

Vizioni i Institutit Pedagogjik të Kosovës është: *Institucion kërkimor – shkencor, lider në Kosovë për hulumtime në edukim - në fushën e veprimtarisë që mbulon.*

Lider në hulumtime në edukim, në fushën e veprimtarisë së që mbulon IPK, janë fjalë kyçe për vizionin e Institutit Pedagogjik. IPK si institucion i pavarur publik në varësi të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka për obligim që të zhvillojë hulumtime të cilësisë së lartë që i kontribuojnë zhvillimit të arsimit në Kosovë dhe integritet të tij në rrjedhat evropiane të arsimit.

Misioni i Institutit Pedagogjik të Kosovës është: *Të ofrojë shërbimeve profesionale për sistemin e arsimit në Kosovë, përmes hulumtimeve, trajnimeve, monitorimit dhe vlerësimit, si dhe publikimeve profesionale në fusha të ndryshme të edukimit.*

Shërbime profesionale për sistemin e arsimit në Kosovë, janë fjalët kyçe për misionin e Institutit Pedagogjik. Kjo nënkupton se Instituti Pedagogjik i Kosovës merr obligim që shërbimet profesionale për sistemin e arsimit në Kosovë ti ofrojë përmes hulumtimeve, trajnimeve, monitorimit dhe vlerësimit në fusha të ndryshme të edukimit, si dhe publikimeve profesionale, me qëllim të përkrahjes së institucioneve arsimore në arritjen dy prioritetëve kryesore të arsimit në këtë fazë: *arsimin gjithëpërfshirës dhe arsimin cilësor.*

Objektivat strategjike. Gjatë procesit të planifikimit janë përcaktuar pesë objektiva për zhvillimin e Institutit Pedagogjik të Kosovës, arritja e të cilave do të qojë në arritjen e vizionit dhe misionit të IPK. Objektivat e përcaktuara janë si në vijim:

1. Zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese dhe hulumtuese për të përmbushur me sukses vizionin dhe misionin e Institutit Pedagogjik të Kosovës.
2. Ngritje e cilësisë së hulumtimeve dhe shërbimeve tjera profesionale për institucionet arsimore *në fushat e planifikimit shkollor, inovacioneve dhe studimeve krahasuese, dhe hulumtimeve sociale.*
3. Ngritje e cilësisë së hulumtimeve dhe shërbimeve tjera profesionale për institucionet arsimore *në fushat e planeve dhe programeve mësimore, standardeve arsimore, vlerësimit dhe zhvillimit profesional.*
4. Ngritje e cilësisë së hulumtimeve dhe shërbimeve tjera profesionale për institucionet arsimore *në fushat e arsimit të përgjithshëm, arsimin profesional dhe arsimin special.*
5. Ngritje e cilësisë së hulumtimeve dhe shërbimeve tjera profesionale për institucionet arsimore *në fushat e arsimit gjatë gjithë jetës, arsimin në distancë dhe arsimin joformal.*

Objektiva 1.: Zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese dhe hulumtuese për të përmbushur me sukses misionin e Institutit Pedagogjik

Zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese dhe hulumtuese përfshinë aspektet që kanë të bëjnë me zhvillimin e kapaciteteve në ushtrimin e autorizimeve ligjore, marrjen e vendimeve strategjike dhe operative, zhvillimin profesional të stafit të IPK, përfshirjen në aktivitete të planifikimit, organizimit, koordinimit, mentorimit, monitorimit dhe vlerësimit.

Zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese dhe hulumtuese është parakusht themelor për sigurimin e cilësisë së shërbimeve profesionale nga Instituti Pedagogjik. Udhëzimin Administrativ i Institutit Pedagogjik të Kosovës, ka hyrë në fuqi me 14.10.2011 ku ka konfirmuar përgjegjësitë e stafit hulumtues, përgjegjësitë e drejtorit, Këshillit Drejtues dhe Këshillit Shkencor në menaxhimin e IPK, mbikëqyrjen dhe përkrahjen e hulumtuesve në punën profesionale të tyre. Ushtrimi cilësor i përgjegjësive të përcaktuara, do të ndikojë në rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të punës së IPK.

Treguesit

- Janë duke u zbatuar të gjitha autorizimet ligjore nga Këshilli Drejtues dhe Këshilli Shkencor.
- Deri në vitin 2016 së paku 50% e projekteve të miratuara për zbatim, mbështeten në kërkesat/ofertat nga MASHT, DKA dhe institucionet shkollore.
- Deri në vitin 2015 sigurohet selia e qëndrueshme e IPK me hapësirë të mjaftueshme për ushtrimin e veprimtarisë.
- Deri në fund të vitit 2013 sigurohet ueb faqja zyrtare e IPK dhe plotësohet me materiale me interes për partnerët me të cilët lidhet veprimtaria e IPK-së.
- Deri në vitin 2016 janë realizuar së paku dy konferenca arsimore në nivel kombëtar;
- Deri në fund të vitit 2013 është hartuar plani i zhvillimit profesional të personelit të IPK 2014-2016 dhe deri në fund të vitit 2016 janë realizuar së paku 80% e aktiviteteve të planifikuara;
- Deri në vitin 2016 janë realizuar së paku tri vizita studimore jashtë vendit

Aktivitetet kryesore - prioritetet

- 1.1. Hartohet rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në IPK, stimulime për ngritje profesionale dhe gradim në karrierë;
- 1.2. Hartohet rregullorja për stimulimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Shkencor në bazë të rezultateve në arritjen e objektivave të IPK;
- 1.3. Hartohet rregullorja për publikimet profesionale të IPK, duke përfshirë edhe marketingun/promovimin e punës.
- 1.4. Organizohen trajnime për stafin menaxhues dhe hulumtuesit e IPK lidhur me ngritjen e kapaciteteve në menaxhimin cilësor të institucionit/sectorëve dhe menaxhimin cilësor të hulumtimeve e aktiviteteve gjegjëse
- 1.5. Organizohen vizita studimore në vende të rajonit dhe BE me qëllim kryesor sjelljen e përvojave të mira dhe risive në reformat e arsimit parauniversitar.
- 1.6. Organizohen dy konferenca arsimore duke përfshirë studiues në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
- 1.7. Hartohet platforma për sigurimin e selisë së qëndrueshme e IPK me hapësirë të mjaftueshme për ushtrimin e veprimtarisë

Objektiva 2.: Ngritje e cilësisë së hulumtimeve dhe shërbimeve profesionale për institucionet arsimore në fushën e planifikimit shkollor, inovacioneve dhe studimeve krahasuese, dhe hulumtimeve sociale.

Cilësia e hulumtimeve dhe shërbimeve profesionale në fushën e planifikimit shkollor, inovacioneve dhe studimeve krahasuese, dhe hulumtimeve sociale, në radhë të parë lidhet me njohjen në thelb të teorisë dhe praktikave të këtyre fushave. Pastaj, ka të bëjnë me njohjen dhe zbatimin e metodologjisë hulumtuese, hartimin e materialeve mbështetëse dhe ofrimin e trajnimeve duke u bazuar në zhvillimet e reja dhe në kontekstin e fushave përkatëse.

Ofrimi i shërbimeve për institucionet arsimore, si nxjerrja e rekomandimeve në bazë të hulumtimeve dhe studimeve krahasuese për përmirësimin dhe avancimin e fushës së planifikimit shkollor dhe zbatimin e ndryshimeve në arsim, përgatitja e udhëzuesve, doracakëve që ndihmojnë e zbatimin në praktikë të përvojave të reja dhe të suksesshme, ofrimi i trajnimeve dhe këshillimeve për mësimdhënës dhe drejtues të shkollave, janë parakushte themelore për sigurimin e cilësisë në fushën e planifikimit shkollor, inovacioneve dhe hulumtimeve krahasuese. Ofrimi i shërbimeve profesionale cilësore në këto fusha kërkon edhe ngritjen e kapaciteteve të stafit hulumtues që mbulojnë këto fusha.

Treguesit:

- Deri në vitin 2016 janë hartuar dhe realizuar së paku 8 projekte të hulumtimeve dhe studimeve krahasuese nga problematikat më rëndësi në fushën e planifikimit shkollor, inovacioneve në arsim dhe hulumtimeve sociale;
- Deri në vitin 2016 janë realizuar së paku 10 analiza dhe studime krahasuese nga tematikat specifike dhe rëndësishme për nga aktualiteti në fushat e planifikimit shkollor, inovacioneve në arsim dhe hulumtimeve sociale;
- Deri në vitin 2016 së paku 50% e projekteve të sektorit të hulumtimeve mbështeten në kërkesat/ofertat nga MASHT, DKA dhe shkollat.
- Deri në vitin 2016 është hartuar, pilotuar, akredituar dhe ka filluar së zbatuari një program i trajnimit nga problematika më me rëndësi në fushën e sektorit dhe në bazë të kërkesave të institucioneve shkollore;
- Deri në 2016 sektori organizon dy Konferenca kombëtare për çështje arsimore;
- Deri në vitin 2016 janë realizuar së paku 2 publikime nga sektori i hulumtimeve

Aktivitetet kryesore

1. Realizon hulumtimet e planifikuara sipas zyrave të sektorit të hulumtimeve
2. Organizohen punëtori me palët e interesit për të identifikuar nevojat dhe për të përcaktuar projektet prioritare të bazuara në kërkesa për hulumtime dhe studimeve krahasuese nga problematikat më rëndësi në fushat e sektorit të hulumtimeve
3. Zhvillohet programi i trajnimit për hulumtimin në veprim dhe materialet e trajnimit (udhëzues dhe doracak të ndryshëm)
4. Ofrohen shërbime profesionale – trajnimi për hulumtimin në veprim
5. Kryhen analizat studimore në fushat - tematikat që i mbulon sektori i hulumtimeve (studime krahasuese, planifikimi shkollor, fusha sociale)

Objektiva 3.: Ngritje e cilësisë së hulumtimeve dhe shërbimeve tjera profesionale për institucionet arsimore në fushën e planeve dhe programeve mësimore, standardeve arsimore, vlerësimit dhe zhvillimit profesional.

Cilësia e hulumtimeve dhe shërbimeve tjera profesionale për institucionet arsimore në fushën e planeve dhe programeve mësimore, standardeve arsimore, vlerësimit dhe zhvillimit profesional, ka të bëjë në radhë të parë me njohjen në esencë të këtyre fushave specifike, me njohjen dhe zbatimin e metodologjisë hulumtuese, hartimin e materialeve mbështetëse dhe ofrimin e trajnimeve duke u bazuar në zhvillimet e reja dhe në kontekstin e fushave përkatëse.

Ofrimi i shërbimeve për institucionet arsimore, si nxjerrja e rekomandimeve në bazë të hulumtimeve, monitorimeve, mentorimeve dhe vlerësimeve për përmirësimin dhe avancimin e aspekteve të veçanta në fushën e planeve dhe programeve mësimore, standardeve arsimore, vlerësimit dhe zhvillimit profesional, përgatitja e udhëzuesve, doracakëve që ndihmojnë e zbatimin në praktikë të përvojave të reja dhe të suksesshme, ofrimi i trajnimeve për mësimdhënës dhe drejtues të shkollave, janë parakushte themelore për sigurimin e cilësisë në fushën e planifikimit mësimor. Ofrimi i shërbimeve profesionale cilësore në këtë fushë kërkon edhe ngritjen e kapaciteteve të stafit hulumtues.

Treguesit:

- Deri në vitin 2016 janë hartuar dhe realizuar së paku 8 projekte të hulumtimeve, monitorimeve, mentorimeve dhe vlerësimeve nga problematikat më rëndësi në fushën e planeve dhe programeve mësimore, standardeve arsimore, vlerësimit dhe zhvillimit profesional;
- Deri në vitin 2016 janë realizuar së paku 10 analiza dhe studime krahasuese nga tematikat specifike dhe rëndësishme për nga aktualiteti në fushat e sektorit të planifikimit mësimor;
- Deri në vitin 2016 së paku 50% e projekteve të sektorit të planifikimit mësimor mbështeten në kërkesat/ofertat nga MASHT, DKA dhe institucionet shkollore.
- Deri në vitin 2016 janë hartuar, pilotuar, akredituar dhe kanë filluar së zbatuari së paku dy programe të trajnimit në bazë të kërkesave të institucioneve shkollore për zhvillim profesional dhe praktika të mira fushat specifike të sektorit të planifikimit mësimor;
- Deri në vitin 2016 janë realizuar së paku 2 publikime nga sektori i planifikimit mësimor.

Aktivitetet kryesore

1. Realizohet faza e dytë e projektit: Zhvillimi i standardeve për shkollat mike për fëmijë - në drejtim të shkollave gjithëpërfshirëse
2. Realizohet faza e dytë e projektit hulumtues: Praktikrat e planifikimit të mësimdhënësve dhe roli i shkollës në planifikim mësimor
3. Hartohet platforma dhe realizohet projekti studimor: Zbatimi i përvojave të trajnimeve të mësimdhënësve në praktikën e mësimdhënies dhe vlerësimit.
4. Organizohen punëtori me palët e interesit për të identifikuar nevojat dhe për të përcaktuar projektet prioritare hulumtuese, monitorimeve, mentorimeve dhe

vlerësimeve nga problematikat më rëndësi në fushën e planeve dhe programeve mësimore, standardeve arsimore, vlerësimit dhe zhvillimit profesional;

5. Hartohen platformat e projekteve prioritare të hulumtimeve, analizave dhe studimeve krahasuese, monitorimeve, mentorimeve dhe vlerësimeve dhe realizohen sipas planit dinamik;
6. Zhvillohen programe dhe materiale për trajnime (udhëzues dhe doracak të ndryshëm) në tematika – fusha të sektorit të planifikimit mësimor;
7. Ofrohen shërbime profesionale – trajnime për programet e trajnimit të hartuara nga fushat e sektorit të planifikimit mësimor;
8. Organizohet aktivitete dhe fushata informimi për institucione arsimore, prindër dhe faktorë të tjerë për menaxhimin cilësor të vlerësimeve të jashtme dhe aktivitete tjera të lidhura me planifikimin mësimor;

Objektiva 4.: Ngritje e cilësisë së hulumtimeve dhe shërbimeve tjera profesionale për institucionet arsimore në fushën e arsimit të përgjithshëm, arsimit profesional dhe arsimit special

Cilësia e hulumtimeve dhe shërbimeve tjera profesionale për institucionet arsimore në fushën e arsimit të përgjithshëm, arsimit profesional dhe arsimit special, ka të bëjë në radhë të parë me njohjen në esencë të këtyre fushave specifike, me njohjen dhe zbatimin e metodologjisë hulumtuese, hartimin e materialeve mbështetëse dhe ofrimin e trajnimeve duke u bazuar në zhvillimet e reja dhe në kontekstin e fushave përkatëse.

Ofrimi i shërbimeve për institucionet arsimore, si nxjerrja e rekomandimeve në bazë të hulumtimeve, studimeve krahasuese, monitorimeve dhe vlerësimeve për përmirësimin dhe avancimin e aspekteve të veçanta në fushën e arsimit të përgjithshëm, arsimit profesional dhe arsimit special, përgatitja e udhëzuesve, doracakëve që ndihmojnë e zbatimin në praktikë të përvojave të reja dhe të suksesshme, ofrimi i trajnimeve për mësimdhënës dhe drejtues të shkollave, janë parakushte themelore për sigurimin e cilësisë së arsimit në fushat e sektorit të arsimit. Ofrimi i shërbimeve profesionale cilësore kërkon edhe ngritjen e kapaciteteve të stafit hulumtues në këtë sektor.

Treguesit:

- Deri në vitin 2016 janë hartuar dhe realizuar së paku 6 projekte hulumtimi, studime krahasuese, monitorimi dhe vlerësimi në fushën e arsimit të përgjithshëm, arsimit profesional dhe arsimit special;
- Deri në vitin 2016 janë realizuar së paku 8 analiza dhe studime krahasuese nga tematikat specifike dhe rëndësishme për nga aktualiteti në fushat e sektorit të arsimit;
- Deri në vitin 2016 së paku 50% e projekteve të sektorit të arsimit mbështeten në kërkesat/ofertat nga MASHT, DKA dhe institucionet shkollore.
- Deri në vitin 2016 është hartuar, pilotuar, akredituar dhe ka filluar së zbatuari së paku një program i trajnimit i bazuar në kërkesat e institucioneve shkollore nga fushat e sektorit të arsimit – AAP, arsimit special apo arsimit të përgjithshëm.
- Deri në vitin 2016 është realizuar së paku 1 publikim i veçantë nga sektori i arsimit.

Aktivitetet kryesore

